

854-2

14.78



Shamra Minarulli,

DITË FESTE

*Djesë Teatrale
me tre tabllo*



891.985-2

S

M.78

BIBLIOTEKA E MIKUT TË VOGËL TË LIBRIT



LIANZA MINAROLLI

MALJUTERA E SHIETI

GJERKASOR

~~10006~~

19601

Ditë Feste

*Piesë teatrale me tre tablo për fëmijë
të moshës së mesme shkollore.*

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



Marrin pjesë

- 1) Çeta e pionierëve (Djem e vajza)
 - 2) Komandanti i çetës — pionier
 - 3) Drejtori i shkollës
 - 4) Komisari (babaj i Besnikut) — ish komisar i një njësi partizan.
 - 5) Punëtori
 - 6) Kooperativistja.
 - 7) Besniku
 - 8) Emira
 - 9) Agimi
 - 10) Genci
 - 11) Teuta
 - 12) Agroni
- } pionierë të çetës

Ngjarja zhvillohet në prag të përvjetorit të themelimit të Partisë:

Pjesa ka karakter festiv.



TABLLOJA E PARË

(Fushë. Në sfond duken oxhaqet e fabrikave, shtyllat e tensionit të lartë dhe akoma më tej kodra të mbushura me taraca.

Në kohën që hapet perdja, nga larg ndihet kënga «Në një dorë kazmën, në tjetrën pushkën», e cila vjen duke u afruar dhe më në fund hyn çeta e pionierëve me këtë këngë në gojë. Ata mbajnë mbi supë kazma dhe lopata.

Çeta radhitet para skenës, me ballë nga publiku dhe kur mbaron kënga ata qëndrojnë gati.)

KOMANDANTI I ÇETËS: Në luftë për çështjen e Partisë të jesh gati!

ÇETA: Gjithmonë gati!

KOMANDANTI I ÇETËS: Këto ditë çeta

jonë, ashtu si i gjithë populli ynë, feston përvjetorin e themelimit të Partisë.

Drejtoria dhe organizata e rinisë, në bashkëpunim me organizatën tonë, kanë menduar që në këto ditë ne të zhvillojmë aktivitete të ndryme. Në këto aktivitete përfshihen edhe pastrimi i kësaj fushe dhe ngritja e një brezi të ri sulmi.

Veç këtyre, sot do të bëhet edhe takimi i çetës sonë me një oficer, ish komisar i reparteve partizane dhe ky është babai i Besnikut. Nesër do të bëjmë një takim tjetër, me një punëtor të dalluar dhe me një kooperativiste të dalluar. Edhe këta janë prindër të pjesëtarëve tanë të çetës. Dhe tani, para se të fillojmë nga puna, le të dëgjojmë vjershën e Besnikut për këto festa.

BESNIKU (del nga rreshti e reciton):

Festë ka sot Shqipëria,
Këngë, valle plot hare,
Brohorasin gjith' nga zemra.
«Rrofsh i madhi jubile!»

Këto zemra janë të njoma,
Por gjith' gaz jan mbushur sot
Po ushtojn' dhe malet tona:
«Rrofsh Parti për jet' e mot»

Ty Parti po të këndojmë,
Ty që nënë je për ne,
Se gjithçka që po gëzojmë
Ti, bujare, na i dhe.

(Të gjithë duartrokasin. Disa zëra thërrasin: «Të lumtë Besnik!» «Të lumtë Besnik!»)

— Çeta shpërndahet nëpër skenë dhe ja fillojnë punës për pastrimin e fushës. Kush me kazmë, kush me lopatë, kush me tezgja janë duke punuar, ndërsa një grup merret me ngritjen e brezit të sulmit. Në skenë thellë vendosen vetëm taraba dhe trari i ekuilibrit.)

EMIRA: (Gjatë kohës që vazhdon puna, duke u mbështetur mbi bishtin e kazmës, e kthyer nga publiku):

Un' e vogël tani jam,
Ndaj s'e njoha varfërinë,
Sot e shoh të lulëzuar
Atëdheun, Shqipërinë.

BESNIKU (Po ashtu):

Edhe gjyshet, si në prallë,
Disa her' na kanë treguar
Si ka qën' atdheu më parë
Dhe si sot është' lulëzuar.

EMIRA—BESNIKU: Na kan' thënë se Partia
Na dha jet' e na çliroi
Nga armiqt' e varfëria,
Që për shekuj na sundoi.

TË GJITHË (duke ngritur nër duar kazma e lopata):

Lavdi ty, Parti e dashur,
Rrofsh sa malet shoku Enver,
Ne për çështjen e Partisë
Jemi gati kurdoherë.

(Djem e vajza lenë kazmat e lopatat dhe duke u kapur për dore hedhin valle tematike.
P.sh.: Si punohet në fabrika ose si prashitet nër ara).

KOMANDANTI I ÇETËS: Çeta! Mblidhu!
(Çeta rreshtohet në qëndrimin Gatitu)

KOMANDANTI I ÇETËS: Qetësohu! Shokë pionierë cilat janë detyrat tona?

ÇETA (NJË ZËRI): Të mësojmë, të punojmë
dhe të kalitemi fizikisht.

KOMANDANTI I ÇETËS: Atëhere, deri sa të
vijë ish komisari i reparteve parti-
zane, ne mund të bëjmë stërvitje në
brezin e ri të sulmit. Gati... tu!
Djathtas... ktheu! Drejtim brezit të
sulmit, gjysmë djathtas, para...
marsh!

(Çeta ecën me hap të rregullt, duke kënduar një marsh. P.sh.: «Shkrep me zjarr por si rrufeja». Me daljen e saj nga skena kënga pushon. Skena errësohet pak dhe kur ndriçohet, pionierët me vrap bëjnë kalimin e brezit të sulmit.

Të gjithë e kalojnë në rregull, vetëm dy pionierë, Agimi dhe Genci nuk e kalojnë dot tarabën dhe trarin e ekuilibrit. Ngaqë kanë frikë dhe përtojnë, ata rrëzohen dhe, në këtë mënyrë, u japin shkak shokëve për tallje e ngacmim.)

KOMANDANTI I ÇETËS: Agim, Genc pse
kaq dobët?

AGIMI: Është e lartë taraba!

GENCI: Edhe trari është shumë i hollë

TEUTA: Po pse, për ne s'janë të lartë e të hollë?

AGRONI: Mos kini merak se për ju do të porositim një tarabë të lartë deri në gju dhe një tra të gjërë sa të kalojë maqina. A ju mjaftojnë?

(Të gjithë qeshin me të madhe. Agimi dhe Genci ulin kryet.)

AGRONI: S'ka fitore që arrihet
Pa lodhje, pa mundim,
Kapërcehen vështirësitë
Me forc' e me guxim.

EMIRA: Kur stërvitur të jesh mirë,
Hasmi s'të shkel dot në prak,
Më shumë djersë në koh' paqe,
Në koh' lufte më pak gjak.

BESNIKU: Edhe ju djersitni cazë,
Jini dhe më luftarakë,
Që mes nesh të mos ketë
Pionierë frikacakë.

KOMANDANTI I ÇETËS: Pushim: Stërvitja

mbaroi. Jeni të lirë. Me të dëgjuar
borien të mblidheni.

(Komandanti i çetës bashkë me Besnikun
venë e shoqërohen me Agimin dhe Gencin
dhe duke u kapur për krahu me ta, drejto-
hen nga publiku.)

KOMANDANTI I ÇETËS: Sot ju të dy u bëtë
qesharakë para shokëve.
Duhet të mendoni për këtë serio-
zisht. Edhe ju, ashtu si shokët, du-
het ta kaloni brezin e sulmit.

AGIMI: Po mua më dhemb këmba...

GENCI: Edhe mua dora

BESNIKU: Ju vuani nga frika dhe dembellëku.

AGIMI—GENCI: S'është e vërtetë.

BESNIKU: Po, po. Ashtu është. (Agimit) Ti
thua «më dhemb këmba», ndërsa
dje luajte për mrekulli futboll me
lagjen. (Gencit) Edhe ti shoku por-
tier dje i kishe duart në rregull që
s'le top të të shpëtojë.

AGIMI: Po unë nuk them kot...

KOMANDANTI I ÇETËS: Ahere bindnani se është ashtu si thoni ju dhe ne atë duam, por, nuk më thoni, kur do të shërohen këmba jote dhe krahu yt?

GENCI: Po pse, vetëm ne jemi ata që s'e kapërcejmë?

KOMANDANTI I ÇETËS: Sot vetëm ju. Kush tjetër?

KOMANDANTI I ÇETËS: Borizan! Bjeri borries të mblidhet çeta.

— (Bie boria. Çeta e gjithë rreshtohet në qëndrim gatitu. Në skenë hyn drejtori i shkollës bashkë me komisarin. Komandanti i Çetës i paraqet forcën komisarit).

KOMISARI: Në luftë për çështjen e Partisë të jesh gati!

ÇETA (një zëri): Gjithmonë gati!

DREJTORI I SHKOLLËS: Shumë prej jush e njohin shokun komisar; babanë e Besnikut. Ai ka qenë partizan dhe ka luftuar me trimëri si gjithë partizanët tanë trima. Ai ka qenë komisar i një batalioni partizan. Edhe

sot është komisar në një repart ushtarak. Ne e thirrëm në këtë takim që të na flasë mbi luftën Nac. Çl. Në emrin tuaj unë e falënderoj dhe i uroj mirseardhjen.

TË GJITHË: Mirseardhët, mirseardhët
Tërë gaz do t'ju dëgjojmë,
Se ne trimat partizanë
Kurrë nuk do t'i harrojmë.

(Një pionier del nga rreshti dhe i lidh oficerit në qafë shaminë e kuqe të pionierit).

KOMISARI: Të dashur pionierë! Jam shumë i lumtur që m'u dha rasti të takohem me ju dhe të bisedojmë bashkë. Edhe unë ju falënderoj për ftesën që më bëtë.

AGRONI: Ju lutemi të na tregoni diçka nga lufta partizane.

KOMISARI: Me gjithë qejf, pionierë të dashur.

TEUTA: Ne do t'ju dëgjojmë me shumë dëshirë.

KOMISARI: Ju kini dëgjuar shpesh mbi Luf-

tën Nac. Çl. që bëri populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Edhe në mësimet tuaja flitet për këtë luftë. Ju shumë a pak e njihni atë, megjithatë edhe unë do t'ju them nja dy fjalë.

Lufta Nacional-Çlirimtare që bëri populli ynë, nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë, është faqja më e ndritur e historisë sonë. Thirrjes së Partisë iu përgjegjën punëtorët, fshatarët, rinia jonë heroike, bile edhe pionierët. Pionerë pati shumë në çetat partizane.

Ne e filluam luftën me një dyfek të vjetër dhe një ballë fishekë, duke u përleshur me një armik të egër dhe të armatosur gjer në dhembë. Me gjithë atë, ne fituam. Fituam sepse udhëhiqte Partia Komuniste me në krye shokun Enver, sepse ishim bij të popullit dhe se populli ishte me ne.

Sot ushtria jonë popullore ndjek traditat e lavdishme të partizanëve trima. Ajo është e armatosur si duhet dhe e gatshme t'i japë përgjigjen

e merituar çdo armiku. Imperialistët me atë amerikan në krye dhe shërbëtorët e tij, revizionistët modernë, kurrë s'kanë për ta mposhtur popullin tonë punëtor dhe heroik. Edhe ju ndihmoni në ndërtimin e socializmit dhe në forcimin e atdheut, duke mësuar sa më mirë, duke punuar dhe duke u kalitur fizikisht.

Dhe tani, sigurisht ju keni dëshirë të dëgjoni ndonjë episod nga lufta partizane.

SHUMË ZËRA: Po, po. Kemi shumë dëshirë.

KOMISARI: Ahere le të ulemi rreth zjarrit partizan.



303 1500

TABLLOJA II

(Skena errësohet. Në mes është ndezur një zjarr. Në sfond ndriçon fort një yll. Çeta është ulur rreth zjarrit partizan, dy-tre veta qëndrojnë në këmbë, kurse në çepet e skenës duken siluetat e rojeve partizane me pushkë.)

KOMISARI: Erdh' një dit' në çetën tonë

Një i vogël pionier,
Kish një trastë me fishekë
Dhe në krah një maliher.

Un' i thashë «Je i vogël»,
Prandaj ktheu në shtëpi.
A e dini ç'm'u përgjegj?
«Do luftoj për Shqipëri!»

TEUTA: Nuk na thoni ku e gjeti
Armën që kishte në krah?

LIBRARI E SHIETAK 1960
40406

KOMISARI: Ishte arma e të atit
Që armiku e kish vra.

«Këtë armë» më tha mua,
«E ka patur ati im,
Po kur ati ra në luftë,
Un' e arma mbem' jetim.

Po ne bashkë muarmë malë,
Edhe erdhëm sot në çetë,
Dhe këtu, mes partizanëve,
Do të bëhem trim me fletë!»

Dhe vërtet, ish shqipe mali
Që nuk trembej nga armiku,
Ai kurrë nuk i njohu
Fjalët «frika» dhe «rreziku.»

Dhe kur plagë trupit mori,
Dhe kur bora mbuloi dhenë,
Dhembje, akull përballoi,
Se luftonte për atdhenë.

EMIRA: A mos vallë është vrarë,
se në luftë, atëherë,
Për lirin' e Shqipërisë
Ranë shumë pionierë?

KOMISARI: Jo, të dashur pionierë,
Ai edhe sot jeton,

Partizan' i vogël dje
Sot Brigadën komandon.

TË GJITHË: Lavdi për jetë partizanëve,
Lavdi dëshmorëve për liri,
Të shenjtin amanet që lanë
E mbron për jetë nëna Parti.

(Skena ndriçohet përnjëherë. Çeta këndon këngë partizane p.sh. «Shqiponjat partizane».)

EMIRA: Shokë! Partizanët trima, nënat dhe baballarët tanë luftuan me heroizëm që atdheu të çlirohej dhe që ne të gëzonim gjithçka që sot na rrethon. Ne jemi fëmijët e këtyre partizanëve dhe me punën tonë duhet t'u tregojmë se jemi bij të denjë të tyre.

TEUTA: Emira ka shumë të drejtë. Ne duhet të mësojmë, duhet të punojmë dhe të kalitemi fizikisht.

KOMANDANTI I ÇETËS: Dhe ne ashtu do vepërojmë. Fjala e Partisë do të jetë ligj për ne. Më lejoni, që në emrin tuaj, t'i shpreh shokut oficer, zotimet tona para Partisë në prag të festës së themelimit të saj. Ne do të

mësojmë sa më mirë, do t'i japim
shoqërisë orë pune vullnetare dhe do
të kalitim trupat tona fizikisht.

KOMISARI: Ju lumtë! Ne jemi të bindur se
ju, brezi i ardhshëm, jeni dorë e si-
gurt e stafetës së socializmit. Ju atë
do ta çoni më tej dhe do t'ua dorë-
zoni me nder fëmijëve tuaj. Ne, për
breza të tillë, siç jini ju, dhe ata që
do të vijnë, luftuam dhe derdhëm
gjakun.

(Të gjithë duartrokasin).

AGRONI: As na thoni edhe ju
Fjalën tuaj të ushtrisë:
Çfar' i çon ajo dhuratë
Në këtë festë, pra, Partisë?

KOMISARI: Kur punëtori dhe fshatari
Gjith' punojnë pa pushuar,
Dhe kur nxënësit nëpër shkolla
Shkojnë me gaz, për të mësuar,

Kur dëbora mbulon dhenë,
Natën kur të gjith' pushojnë,
Ne, ushtarët sytë të mbur,
Gjithëmonë vigjëlojmë.

Mbrojm' kufit' e Republikës,
Punën tonë paqësore,
Kjo të dashur pionierë,
Është dhurata kryesore.

Por dhe ne, përveç stërvitjes,
Maleve u dhamë jetë:
Bukën tonë, për çdo vit,
Do ta nxjerrim tani vetë.

DREJTORI I SHKOLLËS: Siç e dëgjuat,
pionierë të dashur, ushtria e jonë
është populllore, sepse ajo vigjëlon,
stërvitet dhe punon vetëm që jeta e
popullit tonë të jetë e qetë, që ne të
mësojmë e të ndërtojmë.

Tek ne të gjithë janë punëto-
rë dhe ushtarë, sepse ne jemi një
popull që ndërtojmë socializmin,
duke mbajtur në një dorë kazmën
në tjetrën pushkën.

(Të gjithë këndojnë këngën «Në një dorë
kazmën në tjetrën pushkën»).

KOMISARI: Do dëshiroja që ky takim të
mos mbaronte kaq shpejt, por nga
shoku drejtor mësova se ju sot ke-
ni në program të bëni një vizitë në


vorrezat e dëshmorëve të luftës
Nacional Çlirimtare.

Ne do të shihemi edhe herë të
tjera, pra mirupafshim (del bashkë
me drejtorin).

KOMANDANTI I ÇETËS: Programin e mbas
ditës e dini. Në orën e caktuar do
të mblidhemi po këtu, për të vizi-
tuar vorrezat e dëshmorëve. Tani
jeni të lirë.

— Pionierët shpërndahen —

(Fund tablo II)



TABLLOJA III

(Skena është po ajo. Mëngjes herët. Në skenë hyjnë Agimi dhe Genci.)

AGIMI: E, Genc, fillojmë?

GENCI: Me gjithë mend e ke?

AGIMI: Genc, çfarë thua kështu? Ne për këtë punë erdhëm kaq herët.

GENCI: Për këtë, për këtë, por... unë sikur po përtoj një çikë.

AGIMI: Ashtu?! Po mbrëmë ç'biseduam. Pa kujto një herë tregimin e komisarit për atë partizanin e vogël. Ai nuk përtoi të bridhte maleve me dëborë, pa ngrënë e pa pirë, xhveshur dhe zbathur dhe me plagë në trup dhe

jo vetëm kaq, por edhe luftoi si trim. Kaq shpejt harrove? Po talljet dhe qortimet e shokëve, edhe ato i harrove?

GENCI: Shokët na kanë inat.

AGIMI: Jo, Genc, shokët s'kanë inat me ne. Unë po filloj, ti po deshe rri dhe mbaj sehir (**Agimi del nga skena për të vajtur në brezin e sulmit**)

GENCI: (Nga spektatorët) Kot i kundërshtova. Agimi ka shumë të drejtë (**duke u kthyer në drejtimin nga doli Agimi**) Gimi! Gimi pritmë se po vij dhe unë. Do stërvitemi bashkë.

(Skena errësohet dhe pastaj ndriçohet menjëherë. Në skenë duken Agimi dhe Genci duke u stërvitur në brezin e sulmit. Ata ndihmojnë njëri-tjetrin në kapërcimin e tarabës dhe të trarit të ekuilibrit.)

AGIMI: Më shpejt, më shpejt Genci. Për dy orë do të vijë gjithë çeta. Vetëm këto dy orë kemi për t'u stërvitur dhe ne sot me çdo kusht duhet t'ja arrijmë qëllimit.

GENCI: Do t'ja arrijmë Gimi, do t'ja arrijmë.
Edhe një herë tarabën.

AGIMI: Thua ç'të duash, po shokët kanë
të drejtë.

GENCI: Ashtu është. Kemi qenë ca dembela,
por ama s'pranoj të më thonë frika-
cak.

AGIMI: E ç'thua? a të dhëmb më dora?
(qesh).

GENCI: (Duke qeshur) Po ty t'u shëruea këm-
ba?

(Dhe ata, duke ndihmuar njeri tjetrin bëjnë vazhdimisht kapërcimin e tarabës dhe trarit të ekuilibrit. Djersitin. Heqin këmishët. Fillojnë të vepërojnë më me shkathtësi, pa e ndihmuar njeri-tjetrin, por duke e parë njeri-tjetrin dhe duke e koregjuar. Ata fillojnë ta kapërcejnë lirisht brezin e sulmit.

(Kur Agimi me Gencin janë duke u stërvitur, në skenë hyjnë Besniku dhe Agroni, të cilët kur shohin shokët që stërviten, venë t'i ndihmojnë.)

BESNIKU: Ju lumtë (ata stepen). Mos u shqetësoni. Ne do t'ju ndihmojmë.

GENCI: Po ju...

AGRONI: Genc. Ne jemi shokë dhe detyra jonë është që ta ndihmojmë njeri-tjetrin.

BESNIKU: Dhe kur gabojnë, t'i qortojmë, jo pse nuk i duam, por të ndreqen.

AGIMI: Ju kini shumë të drejtë. Ju falemi nderit shokë të dashur. Vazhdojmë.

(Dhe ata të katër, duke ndihmuar njeri-tjetrin stërviten).

AGIMI: Genc, mjaft, po vete ora. Shokët tani vijnë.

BESNIKU: E pastaj... S'ka gjë le të vijnë. Ata do gëzohen.

GENCI: Edhe një herë

AGIMI: Edhe një herë, po shpejt, ama.

(Ata e kalojnë këtë radhë brezin e sulmit më mirë se çdo herë tjetër, bile më mirë se shumë pjesëtarë të tjerë të çetës).

BESNIKU: Ju lumtë, të lumtë, Agim!

AGRONI: Të lumtë Genci. Këtë radhë më

ke pëlqyer më shumë se sa kur hi-
dresh për të pritur topin.

(Ndërkohë në skenë është futur gjithë
çeta).

KOMANDANTI I ÇETËS: Ju lumtë, o shokë,
ju lumtë,

Se faqen na zbardhët dhe ne,
Guximi, vullneti gjithmonë
Pengesat sheshojnë mbi dhe

TË GJITHË: Me punë guxim dhe vullnet
Ne ecim gjithmonë përpara,
Armiqtë i mposhtim më lehtë
Dhe malet i kthejmë në ara.

(Pionierët përqafojnë shokët (Agimin
dhe Gencin) dhe i urojnë ata për sedrën e for-
të dhe vullnetin e tyre. Pastaj Agimi del pa-
ra shokëve).

AGIMI: Shokë! Gjyshi im gjithmonë thotë një
proverbë popullore për dembelat:
«Më sa ma ka qejfi të vete në arë,
aq gjetça që dhe farë». Dhe unë me
Gencin, nga që s'na e mbante dhe
përtonim, thoshim se na dhemb
këmba dhe dora. Apo jo Genci?

GENCI: Agimi ka të drejtë. Ashtu është.

PIONIERËT: (Të gjithë qeshin dhe u rrahin krahët Agimit dhe Gencit).

KOMANDANTI I ÇETËS: Shokë! Shembulli i mirë i Agimit dhe i Gencit na vlen të gjithëve. Ne sot punojmë në tre fronte: në shkollë, në punë dhe në përgatitjen fiziko-luftarake.

TEUTA: Ashtu është shokë. Ne jetojmë të rrethuar nga imperialistët dhe nga revizionistët modernë, prandaj, njëkohësisht duhet të mësojmë, të punojmë dhe të stërvitemi për mbrojtjen e atdheut.

ZËRA TË NDRYSHËM: Ashtu është, ashtu!

BESNIKU: Dhe ne do mësojmë, do punojmë dhe do kalitemi për ta mbrojtur atdheun kurdo që ta lypë nevoja.

EMIRA (këndon): E bukur o shok' është jeta,
E ardhm' e atdheut ne jemi,
Kalitemi për ditët e ardhme,
Partinë farkëtare kemi

GENCI: (këndon): Ne ecim pa frikë në jetë,
Mësojmë, punojmë, dëfretimë,

Dhe po të na thotë partia,
Dhe armët në dorë rrëmbejmë.

TË GJITHË (këndojnë): Kur nesër stafetën do
marrim

Në duart tona çelik;
Përpara atë do ta çojmë,
Do mposhtim në jet' çdo rrezik.

(Ndër kohë që pionierët këndojnë, siç
janë nëpër vende të ndryshme në skenë, nga
jashtë vjen një pionier me vrap).

PIONIERI: Po vijnë! po vijnë! po vijnë!

ZËRA TË NDRYSHËM: Po vijnë, po vijnë!
(dhe bëjnë me shenjë në drejtim nga
priten të vijnë punëtori dhe koo-
perativistja).

KOMANDANTI I ÇETËS: Çeta... mblidhu!
(Çeta radhitet)

TË GJITHË (NJËZËRI): Ja ku erdhën, ja ku
erdhën

Miq të tjerë midis nesh,
Sot është festa e Partisë,
Gjithë Republika qesh.

Qesh punëtori dhe fshatari,
Lavdi miqësisë!
Duart plot ata sjellin
Dhuratat Partisë.

(Në skenë futen drejtori i shkollës, një punëtor dhe një kooperativiste. Komandanti i çetës i paraqet forcën punëtorit dhe kooperativistes. Pionierët duartrokasin miqtë).

PUNËTORI: Në luftë për çështjen e Partisë të jesh gati!

ÇETA: Gjithmonë gati!

DREJTORI I SHKOLLËS: Të dashur pionierë. Sot kanë ardhur midis nesh një punëtor i dalluar dhe një kooperativiste e dalluar. Në këtë takim ne do të mësojmë shumë. Në emrin tuaj dhe të drejtorisë unë iu uroj mirëardhjen dhe i falënderoj. **(Duke u drejtuar nga miqtë).** Miq të dashur. Çeta që është përpara jush është një nga çetat e dalluara në rrethin tonë. Duke vënë në jetë porosinë e Partisë: «Të mësoni, të mësoni, gjithmonë të mësoni», pjesëtarët e kësaj çete kanë dalë me rezultate të mira. Ata janë të dalluar edhe në më-

sime edhe në punë, edhe në përgatitjen fizike. Për këto ata u nderuan me flamurin e Komitetit të rinisë së rrethit për pionierët.

Edhe një herë, të dashur miq, ju uroj mirseardhjen dhe ju falënderoj në emër të çetës.

(Pionierët duartrokasën, ndërsa një pionier dhe një pioniere u lidhën me miqve shaminë e kuqe të pionierit.)

TË GJITHË (këndojnë): Në zjarrin' e luftës
lindi

E madhja miqësi,
Atë e farkëtoi
Për jetë nëna Parti
Një bllok i vetëm sot
Ky popull është' bashkuar,
Atdheun për ta mbrojtur
Dhe për ta lulëzuar

PUNËTORI: Pionierë të dashur. Unë dhe shoqja e ndiejmë veten shumë të gëzuar që jemi midis jush. Dikur edhe ne kemi qenë të vegjël, por femënia jonë me atë tuajën ndryshon si nata me ditën. Femënia ime është

të e mbushur me kujtime të hidhura: netë të tëra pa gjumë, pa bukë, lodhje dhe mundime dhe asnjë për-krahje e kujdesje. Por, edhe shoqja ime, megjithëse më e re se unë, fëmininë e saj e ka kaluar gjysmën në mjerim dhe gjysmën në ato vite të vështira, por heroike, kur ne çlironim atdheun dhe shëronim plagët e luftës.

Kurse ju, ju jeni të lumtur. Sot Shqipëria është e pasur dhe e begatë, është Shqipëri e popullit. Për ju kujdeset Partia jonë e dashur. Ajo është nëna jonë e madhe.

Unë punoj në një uzinë ku riparohen traktorë. Të gjithë ne, ashtu si tërë populli, punojmë për të vënë në jetë detyrat e planit të katërt pesëvjeçar.

AGIMI: Edhe unë ëndëroj që në të ardhmen të punoj në një uzinë.

PUNËTORI: Të lumtë dhe të jesh i sigurtë se atje do ta ndjesh veten të lumtur.

EMIRA: A s'na thoni, ju lutem, si e ndihmoni ju fshatin?

PUNËTORI: Pyetja është mjaft interesante. Ju kini dëgjuar të flitet shumë mbi aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse kooperativiste. Unë do t'ju përgjigjem thjeshtë. Uzina ku punoj unë, riparon traktorë. Siç e dini, traktorët sot përdoren gjerësisht në punët bujqësore. Pra, sa më shumë traktorë dhe sa më shpejt që të riparojmë ne, aq më lehtë do ta ketë punën fshati e aq më tepër do të prodhojë bujqësi. Prandaj të gjithë në uzinë punojnë me një vrull të paparë.

KOOPERATIVISTJA: Kurse ne në fshat bëjmë çmos, duke punuar me të gjitha forcat, që të kemi prodhime sa më të bollshme, që fshati dhe qyteti, gjithë populli ynë, të ushqehet dhe të vishet më mirë.

TEUTA (reciton): Punëtori i dalluar
Duarartë sot prodhon
Gjithë të mirat që na duhen,
Gjithçka populli kërkon.

Nër fabrika, nër uzina
Nër kantiere, kombine

Gjith' pa reshtur po punojnë,
Turne dite, turne nate.

AGIMI: (Duke iu drejtuar punëtorit)

As na thoni, këtë festë
Ju me se do ta festoni,
Dhe Partisë si dhuratë
Për dit' lindje, ç'do t'i çoni?

PUNËTORI: Ne Partis' me punën tonë

Mijra vepra i dhuruam,
Dhe gjithçka i duhej popullit
Ne në vend e prodhuam

Ja, për ju shkolla të reja,
Mjete mësimi, libra plot,
Veshje, mbathje si përhera
Po ju sjellim edhe sot.

TË GJITHË: Lavdi juve o shok' punëtor,

Ju klasa pararojë!

BESNIKU: Ju ndërtoni Shqipërinë

Që mes shëkuajsh do jetojë

EMIRA: Dhe krah jush fshatarësia

Ësht' radhitur dhe punon,
Fshatn' e djeshëm në qytet
Dalngadal po e shndërron

GENCI (reciton): Tok' e djeshme e çifligarit

Sillte lotë dhe mjerim,
Sot kjo tok' është e fshatarit,
Sjell bollëk edhe gëzim

Këtë tok' ja dha Partia
Dhe fshatarin e mësoi,
Për të ardhmen socialiste
Tok' e punë t'i bashkojë.

AGRONI (duke iu drejtuar kooperativistes)

As na thoni edhe ju
Me se festën e festoni?
Dhe Partisë si dhuratë
Për dit'lindje, ç'do t'i çoni?

KOOPERATIVISTJA: Çamë kodra, male plot

Gjith taraca i mbuluar
Tokat djerr' në toka buke
Ne me punë i shndërruar

Grurë, misër dhe patate
Pemë frutore, vreshta plot
Dhe perime në çdo anë
S'lam pëllëmbë të shkoj' kot.

Si dhuratë për dit'lindje
Ne i sjellim sot Partisë:
Fshatarësia do prodhojë
Bereqetin' e Shqipërisë.

(Pionierët duartrokasin, pastaj hedhin vallet tematike, p.sh. si korret gruri ose si prashitet në arë).

PUNËTORI: — Fjalët këngët, vallet dhe vjershat tuaja janë të zjarrta. Ato na mbushin me gëzim dhe na shtojnë forcat.

Unë do t'ju flas shokëve të mi për pritjen tuaj, për gëzimin tuaj dhe për punën tuaj. Shumë prej jush vitet e ardhshme do të vijnë të bëjnë punën praktike nëpër uzina. Ne do t'ju mirëpresim, do t'ju mësojmë shumë gjëra të vlefshme për jetën dhe do t'ju njohim më mirë me jetën dhe punën tonë.

KOOPERATIVISTJA: Vëllezërit dhe motrat tuaja punuan këtë verë bashkë me ne. Ata i dhanë fshatarësisë një ndihmë shumë të madhe. Mot ju presim të na vini dhe vetëm kur të jini midis nesh, do ta njihni më mirë jetën e fshatit, përparimet e fshatit, punët e tij dhe natyrën e bukur.

DREJTORI I SHKOLLËS: Të dashur pionierë! Ne, me të drejtë, u interesuam të mësonim prej miqve tanë se ç'kanë bërë ata dhe shokët e tyre dhe me ç'dhurata shkojnë në përvjetorin e themelimit të Partisë. Por, ama, unë jam i sigurt se edhe këta kanë dëshirë të madhe të mësojnë për punën tonë dhe se si e presim edhe ne pionierët përvjetorin e themelimit të Partisë sonë të dashur. Unë besoj se ata do të na pyesin, prandaj ne më mirë le t'ua themi vetë.

PUNËTORI DHE KOOPERATIVISTJA: Ash-tu është.

AGRONI: Të dashur miq! Detyra jonë e parë është të mësojmë.

(Porsa mbaron fjalët Agroni, skena errësohet për një çast dhe kur ndriçohet, në dy cepet e skenës janë vendosur dy dërrasa të zeza. Dy nxënës bëjnë në to ushtrime algjebre dhe gjuhe. Një grup punon me tekstin dhe me hartën gjeografike, dikush studion vetë, një tjetër u spiegon shokëve. Një grup janë rreth një tornoje, punojnë ose imitojnë saidatorin etj. etj.)

(— Kjo skenë zgjat 1-2 minuta —)

TEUTA: Por detyra jonë është edhe të punojmë.

(Pas errësimit dhe ndriçimit përsëri të skenës, çeta merr kazmat, lopatat, tezgat etj. dhe bën imitim pune: gërmim me kazma, he-dhje dheu me lopatë dhe transport me tezga).

(Edhe kjo skenë zgjat 1-2 minuta)

BESNIKU: Atdheu ynë është i rrethuar me armiq. Imperializmi amerikan, armiku i popujve dhe shërbëtorët e tij revizionistët modernë e kanë halë në sy lulëzimin e vendit tonë.

EMIRA: Ata rrinë e përgjojnë që të na kapin në befasi. Por, kjo nuk do të ndodhë kurrë! Ata nuk do t'ja arrijnë kurrë qëllimit të tyre, sepse ne jemi të përgatitur për t'ja thyer hundët në çdo kohë.

AGIMI: Prandaj edhe ne stërvitemi

(Skena erësohet dhe kur ndriçohet, çeta bën kalimin e brezit të sulmit me shpejtësi).

(— Edhe kjo skenë zgjat 1-2 minuta—)

PUNËTORI: Ç'ka pamë e dëgjuam mes jush,

Tregon dashuri për Partinë,
Kur nesër stafetën do merrni,
Më lart do t'ja ngrini lavdinë.

KOOPERATIVISTJA: Në bankat e shkollës
mësoni

Nër ara, fabrika... punoni
Dhe trupin kalitni gjithmonë
Se jeni e ardhjma e jonë

(të gjithë duartrokasin)

AGIMI: Dhe tani dëgjoni këngën tonë për
Partinë.

TEUTA: Ty Parti po të këndojmë,
Ty që nënë je për ne,
Se gjithçka që po gëzojmë
Ti bujare na i dhe.

BESNIKU: Këto zemra janë të njoma,
Por gjith' gaz janë mbushur sot,
Po ushtojnë malet tona:
Rrofsh Parti për jet' e mot!»

TË GJITHË: Festë ka sot Shqipëria,
Këngë, valle plot hare,
Brohorasin gjith nga zemra:
«Rrofsh i madhi jubile.»

(Të gjithë së bashku, me kazma, lopata,
libra dhe pushkë në duar, këndojnë këngën:
«Në njerën dorë kazmën në tjetrën pushkën».
Kjo këngë është finalja).

(Bie perdja)

